



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 898 / Prot.

Tiranë, më 09.07.2024

VENDIM

Nr. 93, datë 09.07.2024

MBI

“MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE - BACHELOR NË “MUZIKË JAZZ”, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1, shkronja d të nenit 38, në pikën 1 dhe 3 të nenit 71 si dhe në nenin 73 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24, pika 1, shkronjat g dhe h të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresën Nr. 898 Prot., datë 08.07.2024 të Dekanit të FM, me lëndë “Dërgimi i rregulloreve mësimore të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Muzikë Jazz dhe Perkusion për miratim në Senatin Akademik të UA”, pasi e shqyrtoi dhe diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë të studimeve – Bachelor në “Muzikë Jazz”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi, të dërguar nga Fakulteti i Muzikës.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore e FM si dhe Sektori Mësimor & Kurrikulës, Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 888 Prot.

Tiranë, më 28 . 07 2024

Lënda : Dërgimi i Rregulloreve Mësimore të Ciklit të parë të studimeve Bachelor në Muzikë Jazz dhe Perkusion për miratim në Senatin Akademik të UA

Rektor

Universiteti i Arteve

Sheshi "Nënë Tereza" Tiranë

Për dijeni

Senati Akademik

I nderuar Prof. Çausi,

Në cilësinë e Kryetar të Senatit Akademik të UA po ju përcjellim për aprovim Rregulloret Mësimore të Ciklit të parë të studimeve Bachelor në Muzikë Jazz dhe Perkusion të Fakultetit të Muzikës.

1. Bachelor në Perkusion
2. Bachelor në Muzikë Jazz



Prof.Dr. Isak SHEHU

Dekani i Fakultetit të Muzikës


UNIVERSITETI I ARTEVE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE



**RREGULLORE MËSIMORE
E CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE
BACHELOR
NË
MUZIKË JAZZ**

Miraturar me Vendim të Senatit Akademik

Nr. _____ datë ___ / ___ / _____

1

1



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KREU I

PROGRAMI I STUDIMIT

Neni 1

Sistemi i studimeve

Programi i studimit “Muzikë Jazz” ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit, Fakulteti i Muzikës (FM), Universiteti i Arteve (UART). Programi i studimit realizohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, në përputhje me nivelin 6 (gjashtë) sipas Nivelit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)

Neni 2

Kohëzgjatja e programit të studimit

1. Kohëzgjatja normale e programit të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor në “Muzikë Jazz” është tre vite akademike, në përfundim të së cilës studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite.
2. Programi i studimit Bsc në “Muzikë Jazz” është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite (ECTS). Sasia minimale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.

Neni 3

Kreditet

1. Një kredit të formimit universitar i korrespondon 25 (njëzet e pesë) deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore pune të studentit e llogaritur si orë në auditor dhe orë pune të pavarur individuale. Sasia mesatare e punës së kryer nga studenti gjatë një viti studimesh universitare me kohë të plotë është 1500 (një mijë e pesëqind) deri në 1800 (një mijë e tetëqind) orë mësimore pune të studentit (60 kredite), që përfshijnë orë në auditorë dhe orë për punë të pavarur të tij. Kjo sasi ndryshon në favor të punës së pavarur individuale në lëndët profesionale artistike.
2. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore vjetore.
3. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për lëndë speciale instrument jazz, leksione, seminare, ushtrime, (ansambël combo dhe bigband), laboratorë/praktika (koncerte ëorkshop, masterclass, recording session), projekte individuale të studentëve, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore 50-minutëshe.
4. Studenti fiton kreditet për çdo veprimtari formuese (lëndë speciale artistike, lëndë teorike, praktika, diplomë, reçensa etj.), vetëm në rast të një vlerësimi pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tij.

Neni 4

Veprimtaritë formuese të programit të studimit



1. Në Universitetin e Arteve veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimit në auditor (lëndë speciale në instrument jazz, leksione, seminare, ushtrime, koncerte (ansambël combo dhe bigband), laboratorë (ëorkshop, masterclass, recording session), studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh artistike dhe shkencore, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës) dhe praktika profesionale, etj.
2. Në programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, veprimtaritë formuese grupohen mbi bazë të objektivave formuese që sigurojnë, duke respektuar disa raporte të përafërta si më poshtë vijon:
- 3.

Kategoria	Komponenti mësikor	Cikli i parë (Niveli 6 i KSHK-së)
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	23 ECTS
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	105 ECTS
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - nën disiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	28 ECTS
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	14 ECTS
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	10 ECTS

KREU II

DOKUMENTACIONI THEMELOR I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Neni 5

Organizimi i programit të studimit dhe Objektivat e tij

Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Muzikë Jazz” mbështetet në hartimin e dokumentacionit themelor të tij që janë:

- a) Plani mësikor.
- b) Programet mësimore të disiplinave përbërëse.

Objektivat e programit të studimit Bachelor në “Muzikë Jazz” janë:

Formimi dhe aftësimi profesional i studentëve si instrumentistë jazz performues, kompozitorë, aranxhues, producentë muzikorë dhe mësimdhënës të aftë për një karrierë të ardhshme brenda dhe jashtë vendit me drejtim specifik në muzikën e quajtur "jazz" dhe stilet e tjera moderne (pop, rock, funk, r&b, hip-hop, etno-jazz, fusion, ëord music etj) për të përballuar problematikat e fushës përkatëse dhe nevojat e tregut artistik, kulturor në këto drejtime:

- Instrumentist solist;
- Instrumentistë të formacioneve të muzikës jazz, orkestrave big band si dhe të orkestrave të të gjitha zhanreve muzikore;
- Producentë (kompozitorë, aranxhues);



- Punonjës të rrjetit të institucioneve arsimore dhe kulturore;
- Punonjës të administratës publike sipas legjislacionit në fuqi

Neni 6 Plani mësimor

1. Tërësia e veprimtarive formuese shprehen në planin mësimor, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilën parashtrihen në mënyrë të sintetizuar sa më poshtë vijon:
 - a) Emërtimin e programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve
 - b) Tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave
 - c) Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione/ speciale/ ushtrime/ seminare/ detyra/ projekte, praktika profesionale artistike, etj.), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor,
 - d) Karakteristikat e tezës së diplomës
2. Plani mësimor është objekt rishikimi dhe vlerësimi periodik.

Neni 7 Programi mësimor i lëndës

1. Programi mësimor i lëndës/syllabusi është hartuar për çdo disiplinë që përmban plani mësimor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 *‘Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si Institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë’*. Programet e studimit që ofrohen në UART kanë natyrë specifike dhe syllabuset e tyre kanë elementë dhe përbërje të veçantë. Në programin mësimor të lëndëve është dhënë në formë të përmbledhur:
 - a) Emërtimi i lëndës.
 - b) Titullari/pedagogu i lëndës.
 - c) Ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në auditor, studio, sallë dhe mënyra e zhvillimit të tyre si lëndë artistike, klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.).
 - d) Viti akademik/semestri kur zhvillohet.
 - e) Lloji i lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje).
 - f) Programi i studimit (program për të cilën ofrohet kjo lëndë).
 - g) Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës.
 - h) Kodi i etikës.
 - i) Përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit (përmbledhje që përmban idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës dhe synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që çdo student pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës).
 - j) Konceptet themelore (konceptet mbi të cilat ndërtohet lënda).
 - k) Temat e lëndës (shpjegim rreth një paragrafi i çdo teme të leksionit sipas javëve).
 - l) Format e kontrollit të dijeve.



- m) Frekuentimi.
 - n) Kontrolli i vazhdueshëm (format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare).
 - o) Literaturë e ndarë në literaturë bazë e detyrueshme dhe literaturë e rekomanduar
 - p) Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës.
2. Programi mësimor i lëndës (syllabusi) hartohet nga drejtuesi i lëndës. Kur nuk ka të tillë, me propozim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe me Urdhër të Dekanit mund të përgatitet nga një grup i personelit akademik me kohë të plotë dhe më pas konsultohet me grupin përkatës mësimor pranë departamentit.

Neni 8

Rregullorja mësimore e programit të studimit

1. Kjo Rregullore mësimore e programit të studimit Bsc në “Muzikë Jazz” është hartuar mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë të UART”. Rregullorja e programit është hartuar nga Departamenti i Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, përgjegjës për programin e studimit, vlerësohet dhe miratohet në Dekanat, së bashku me programin përkatës të studimit, në përputhje me procedurën e hartimit, rishikimit dhe miratimit të programeve të reja të studimit. Çdo program studimi ka natyrën e tij specifike dhe si i tillë edhe kjo Rregullore është hartuar duke patur parasysh këtë natyrë specifike të saj.
2. Rregullorja mësimore e programit të studimit Bsc në “Muzikë Jazz”, është objekt rishikimi periodik, kur ajo shihet e nevojshme për tu bërë. Rishikimi bëhet para fillimit të vitit të ri Akademik, (zakonisht në mbyllje të vitit Akademik aktual dhe jo më vonë se tre javë përpara fillimit të vitit të ri akademik) dhe synon të korrigjohen problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, të përmirësohen dhe përditësohen elementë të ndryshëm të programit të studimit.

Neni 9

Pranimi i studentëve në Programet e studimit të ciklit të parë

1. Në UART kandidatët për studentë i nënshtrohen konkurseve të pranimit për të gjitha programet e ciklit të parë që ofrohen. Edhe për këtë program studimi veprohet si për të gjitha programet e tjera. Çdo fillim viti akademik, Fakulteti i Muzikës harton Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit për çdo vit akademik. Kjo Rregullore miratohet me Vendim të Senatit Akademik dhe publikohet në faqen ëeb të UART.
2. Konkursi organizohet në zbatim të rregullores dhe kritereve të miratuara në Senatin Akademik të UART në çdo vit akademik.
3. Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar (të ndjekë) studimet në këtë program studimi.
4. Konkursi për programin e studimit Muzikë Jazz zhvillohet në dy faza. Faza e parë përfshin provim me shkrim në disiplinat Solfezh dhe Harmoni.
Prova e Solfezhit përmban:
 - Diktat ritmik – me metrikë të thjeshtë dhe të përbërë të një shkalle vështirësie mesatare.
 - Diktat melodik me një zë në kufinj të harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe



- modulacione të gradës së parë;
- Dëshifrim kuintakordesh dhe septakordesh me përmbysje me anë të dëgjimit;
- Diktat melodik me dy zëra të një shkalle të lehtë vështirësie, brenda kufinjve të harmonisë tonale;

Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim të vështirësisë mesatare, si më poshtë:

- Harmonizim i një melodie të dhënë;
- Harmonizim i një basi të dhënë;

Faza e dytë – të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërdrejtë me kërkesat e specialitetit Muzikë Jazz;

Repertori i detyruar për çdo kandidat për studentë është:

- Interpretim i një materiali teknik (shkallë/teknikë stilistike/etyd) në instrumentin që do të zgjedhë si lëndë speciale në Muzikë Jazz, të zgjedhur sipas dëshirës nga metodat e paraqitura në Rregulloren e konkursit të pranimit të kandidatëve për studentë, të miratuar me Vendim të Senatit Akademik, për çdo vit akademik.
 - Të interpretojnë një pjesë “jazz standard” me improvizim solo të vështirësisë së gradës së parë, të zgjedhur sipas dëshirës nga Real Book Vol. I, II, III. Interpretimi mund kryet solo dhe/ose në formacion (duo, trio, kuartet) me muzikantë që i angazhon vetë studenti ose me anë të bazave “playalong”.
 - Lexim dhe dëshifrim a prima vista nga: Real Book Vol. I, II, III
5. Studentët për të ndjekur këtë program studimi mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Preshevë-Bujanovca, Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi dhe nga vende të tjera nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe të certifikuar nga institucionet përgjegjëse.
 6. Për specifikime të tjera në lidhje me pranimin e studentëve në këtë program studimi, respektohen të dhënat e paraqitura në Rregulloren e ciklit të parë të studimeve në UART.

Neni 10

Regjistrimi i studentëve

1. Kandidati fitues në programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, regjistrohet pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës në UART
2. Pas marrjes së dokumentacionit nga kandidati dhe regjistrimit të tij, sekretaria e Fakultetit bën regjistrimin online në Portalin U-Albania.
3. Kandidati dorëzon personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë të posaçme nga ana e tij/saj, dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kandidati plotëson deklaratën në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të Fakultetit dhe nënshkruhet nga të dy palët.
5. Sekretaria mësimore, mban regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit ku vlerësohet data dhe ora e dorëzimit si dhe nënshkrimi i/e kandidatit të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të kandidatit kryhet regjistrimi online në Portalin U-Albania.
6. Në fund të kësaj procedure printohet nga sistemi regjistrimi elektronik i formularit dhe firmoset në dy kopje nga aplikanti dhe sekretarja. Një kopje i jepet kandidatit.
7. Dosja e regjistrimit të kandidatit fitues si student në programin e studimit Bachelor në Muzikë Jazz, përmban:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- a) Dokumentin e identifikimit (ID ose pasaportë), në dosje mbahet vetëm fotokopje.
- b) Fotokopje e noterizuar e Diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar nga institucioni përkatës për këtë procedurë.
- c) Deklaratën e plotësuar nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të nënshkruar nga të dy palët.
- d) Kontrata e studentit.
- e) 2 fotografi.
- f) Dokument që vërteton pagesën e tarifës së regjistrimit.

KREU III

ORGANIZIMI I STUDIMEVE UNIVERSITARE

Neni 11

Format e Mësimit dhe Format e Kontrollit

Forma e mësimit dhe Forma e kontrollit në programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz” kryhet ashtu siç është përcaktuar edhe në Rregulloren e ciklit të parë të studimeve për të gjitha programet Bachelor që ofrohen në UART. Konkretisht:

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të parashikuara në planin mësimor të programit Bsc në “Muzikë Jazz” dhe programet e lëndëve. Format kryesore të punës mësimore janë:
 - a. Format e mësimit teorik e praktik individuale dhe kolektive: speciale instrument jazz, leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, projektet artistike individuale dhe kolektive, laboratorë (ëorkshop, masterclass, recording sesion), koncerte (ansambël combo, bigband), konsultimet, detyrat e kursit etj.
 - b. Format e kontrollit të dijeve: bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtjet e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike (koncerte në ansambël combo dhe bigband, ëorkshop, masterclass, recording sesion, projekte individuale të studentëve, etj).
2. Kontrolli i dijes mund të bëhet nëpërmjet:
 - a) Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special në instrument jazz) konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit. Provimet me shkrim në lëndët teorike;
 - b) Provimit me gojë;
 - c) Vlerësimin të detyrave dhe të projekteve muzikore;
 - d) Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt;
 - e) Provimi në grup;
3. Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të kategorisë së disiplinës së lëndës dhe është e pasqyruar në sylabusin e saj. Ai përcaktohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me Përgjegjësën e Njësisë Bazë/Departamentit, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga Dekani. Në UART njihen disa mënyra të organizimit të provimit si më poshtë vijon:
 - a) Provimi i lëndës artistike speciale në instrument jazz.



- b) Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar.
 - c) Provimi me shkrim e me gojë, ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë në provimin me gojë.
 - d) Provimi si individ apo në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar.
4. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.
 5. Në formën e kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara.
 6. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/ët i/e lëndës. Ato miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit dhe nënshkruhen prej tij/saj.
 7. Format e mësimit konkretizohen në hartimin nga sekretaria mësimore të dokumentave të mëposhtëm, të cilat shpallen 5 (pesë) ditë para fillimit të vitit të ri Akademik.
 8. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është është nga 30 (tridhjetë) deri në 60 (gjashtëdhjetë) orë mësimore 50-minutëshe.
 9. Format e kontrollit të dijeve konkretizohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilat pasqyrohen nga sekretaria mësimore mbi bazën e propozimeve të departamenteve. Grafiku i detyrimeve shpallet deri në dy javë pas fillimit të semestrit.

Neni 12

Organizimi i procesit mësimor

Organizimi i procesit mësimor në programin e studimit Bsc në “Muzikë Jazz” do të zhvillohet ashtu siç edhe të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të ofruara në UART dhe të përcaktuara hollësisht në Rregulloren e Ciklit të parë të Studimeve.

Neni 13

Kurset, Grupet mësimore dhe orët individuale

1. Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi, kursi dhe orë individuale.
2. Grupet mësimore dhe numri i studentëve në to bazohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë procedurë. Duke respektuar specifikën e programeve mësimore të fakulteteve, zhvillohen lëndët individuale artistike, seminarët, punët praktike, laboratorët, ushtrimet, etj..
3. Numri i studentëve në grupet mësimore ndahet si më poshtë:

Numri i studentëve për lëndët individuale artistike	Numri i studentëve për mësim artistik në grup	Numri i studentëve për seminare	Numri i studentëve për praktika apo shoqërim në piano	Numri i studentëve për leksion	Numri i studentëve në laborator
1 student	1-15 studentë	1-15 studentë	1-15 studentë	1-6 grupe seminari	1-15 studentë



4. Ndarja e grupeve dhe e kurseve bëhet nga Përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit sipas tabelës së mësipërme dhe miratohet me vendim të Dekanit.
5. Orët artistike janë një specifike e Universitetit të Arteve dhe janë të shpërndara në disa lëndë brenda fakultetit të cilat janë: speciale, sekondare, ndihmëse, etj.
6. Dekani zbaton përcaktimet e mësipërme në përputhje me mundësitë reale dhe aktet nënligjore në fuqi.
7. Ndarja e studentëve në kurse, grupe dhe orë individuale, fiksohet në regjistrat e vitit, të cilët janë dokumente zyrtare ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimit nga pedagogët.

Neni 14 **Zhvillimi i mësimit**

1. Koha dhe auditori ku zhvillohet mësimi përcaktohet në orarin e shpallur nga sekretaria mësimore, i cili duhet të respektohet me rigorozitet nga të gjithë mësimdhënësit dhe studentët. Orari ndërtohet mbi kritere metodike e pedagogjike, duke mbajtur parasysh harmonizimin e formave të ndryshme të mësimit (artistike speciale instrument jazz, leksion, seminar/ushtrime, laboratorë, praktika, etj.), të disiplinave të ndryshme, dhe shpërndarjen racionale të ngarkesës së studentit.
2. Ndryshimet në orar mund të bëhen me propozim të pedagogut të lëndës, duke e argumentuar atë. Më pas është Përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit që e shqyrton dhe nëse e gjykon të arsyetuar, atëherë ja dërgon për miratim përfundimtar Dekanit të Fakultetit të Muzikës. Mos paraqitja apo mos realizimi i orës mësimore nga personeli akademik i ngarkon me përgjegjësi administrative.
3. Raste përjashtimore janë vetëm mosparaqitja e mësimdhënësit për arsye të parashikuara në Statut dhe Rregulloren e UART (realizime të projekteve artistike dhe shkencore, organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete jashtë shtetit, fatkeqësi familjare etj.). Edhe në këto raste seanca mësimore zëvendësohet në një ditë tjetër të përcaktuar e miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit në bashkëpunim me pedagogun e lëndës. Sekretaria mësimore ndjek dhe evidenton çdo ditë ecurinë e procesit mësimor.
4. Ora mësimore akademike zgjat 50 minuta sipas përcaktimit në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

KREU IV

PJESËMARRJA E STUDENTËVE NË MËSIM

Neni 15 **Frekuentimi**

1. Studenti i cili do të studiojë në programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, është i detyruar që para fillimit të vitit akademik të paguajë tarifën vjetore të shkollimit për atë vit Akademik, në të kundërt ndaj tij merret masa e ndërprerjes së studimeve dhe përjashtimit nga Universiteti i Arteve. Për të gjithë ato studentë që përjashtohen nga tarifa e shkollimit ose që përfitojnë bursë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë



- procedurë, vlera monetare e pagesës të derdhur për UART i rikthehet me vendim nga Bordi i Administrimit secilit student.
2. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies të disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme për frekuentimin e tyre përcaktohet nga rregulloret e secilit fakultet.
 3. Për format e mësimimit me frekuentim të detyruar, kur studenti me ose pa arsye, nuk merr pjesë në mbi 25% të numrit të seancave të zhvilluara në një lëndë, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e mëtejshme të asaj lënde. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimimit në vitin pasardhës, duke përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rregulloret për këtë procedurë.
 4. Pedagogu i lëndës njofton Përgjegjësin e Njesisë Bazë/Departamentit dhe Sekretarinë mësimore me shkrim, për studentët të cilët kanë arritur masën me 25% të mos frekuentimit të procesit mësimor. Në mos njoftimi në raste të tilla, pedagogu duhet të mbajë përgjegjshmëri administrative.
 5. Pjesëmarrja e studentit evidentohet rregullisht dhe monitorohet nëpërmjet regjistrit të kursit/grupit. Sekretaria mësimore monitoron rregullisht frekuentimin e studentëve në aktivitetet mësimore, evidenton çdo shkelje të kufijve minimal të pranuar në bazë edhe të raportimit të pedagogut të lëndës. Sekretaria mësimore informon Dekanin me shkrim, rast pas rasti, për shkeljet e konstatuara. Këto raste i bëhen të njohura me shkrim edhe studentit.

KREU V

KONTROLLI I DIJES

Neni 16

Mënyrat e të provuarit të dijes

1. Për të vlerësuar njohuritë, studenti që do të ndjekë programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, vlerësohet me notë. Për notat përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal. Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese.
2. Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për vlerësimin e studentit mund të përdoret edhe vlerësimi pozitiv/negativ, vetëm për ato lëndë që është e përcaktuar në planin mësimor.
3. Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë, apo moduli të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, laboratorë në ansambël combo dhe bigband, kontrollet e pjesshme, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtar është e lidhur me peshën që zënë ato në ndarjen e krediteve të lëndës sipas veprimtarive formuese të saj, të përcaktuara në planin mësimor dhe në programin e lëndës.
4. Në syllabusin e lëndës/modulit shprehen modalitetet e vlerësimit të saj.

Neni 17

Parakushtet për hyrje në provim



1. Studenti që do të ndjekë programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur:
 - a) ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë të parashikuara në planin mësimor;
 - b) e lejon grafikun i ndërvarësisë së lëndëve;
 - c) plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;
 - d) ka mbrojtur detyrimet për praktikatat mësimore, punët laboratorike në se lënda parashikon forma të tilla, brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve, para fillimit të sezonit të provimeve;
 - e) të jetë regjistruar në sekretarinë mësimore për dhënie provimi në sesionin dhe datën përkatëse;
 - f) ka paguar tarifën e shkollimit;
2. Studenti i cili nuk plotëson këto parakushte nuk lejohet për asnjë lloj arsye të hyjë në provimin e lëndës përkatëse.

Neni 18

Sezonet e Provimeve

1. Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit Akademik. Datat e tyre propozohen nga Departamenti i Interpretimit, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.
2. Provimet, zhvillohen në tre sezone:
 - a) sezoni i provimeve të dimrit;
 - b) sezoni i provimeve të verës;
 - c) sezoni i provimeve të vjeshtës.
3. Sezoni i provimeve të dimrit zhvillohet mbas përfundimit të semestrit të parë. Sezoni i provimeve të verës zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë. Sezoni i vjeshtës zhvillohet përpara fillimit të vitit akademik pasardhës.
4. Nëse studenti nuk ka shlyer detyrimet e lëndës në kohën normale të zhvillimit të saj, ai duhet t'i shlyejë ato para fillimit të sezonit të provimeve, në periudhën e shpallur nga Dekani. Nuk lejohet shlyerja e detyrimeve të lëndës përgjatë sezonit të provimeve.
5. Për lëndët e formimit special, të zhvilluara në grup, studenti merr vetë nën përgjegjësinë e tij përgatitjen mbi organizimin dhe realizimin e provimit, në sezonin e shlyerjes jashtë kohës normale të sezonit të provimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.
6. Studenti, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda një sezoni. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.
7. Studentët të cilët nuk hyjnë në provime në tre sezonet e vitit akademik, në sezonet e vitit pasardhës janë të detyruar të paguajë tarifën e provimit apo detyrimin sipas rastit dhe të përcaktuara në rregulloret e fakulteteve.

Neni 19

Provimi dhe kontrolli i dijeve

1. Dekani i Fakultetit të Muzikës, pranë të cilës do të ofrohet ky program studimi, përcakton me urdhër masat që duhet të merren për organizimin e provimeve. Dekani (Zëvendës



- dekani në rastet kur është i emëruar) është përgjegjës për zbatimin e rregullave për realizimin e procesit të provimeve.
2. Provimet zhvillohen në orën, datën dhe ambientin e caktuar nga njësia bazë, të cilat reflektohen në orarin e provimeve, të shpallur 2 (dy) javë para fillimit të sezonit.
 3. Në raste të jashtëzakonshme, në pamundësi të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim, e anulon dhe cakton një datë të mëvonshme brenda sezonit apo jashtë sezonit, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve, e cila i bëhet e njohur studentëve.
 4. Komisioni i provimit të lëndës përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që janë titullarë të lëndës/ve. Komisioni i provimit të lëndës ngrihet me Urdhër të Dekanit të Fakultetit të Muzikës pas propozimit të bërë nga Përgjegjësi i Departamentit të Interpretimit. Kryetar i komisionit të provimit emërohet pedagogu me titull akademik më të lartë. Komisioni i provimit duhet të ketë jo më pak se 3 (tre) anëtarë.
 5. Komisioni i provimit të lëndës duhet të ketë në përbërje anëtarë nga stafi akademik, ngarkesa mësimore e të cilëve, përmban lëndën dhe studentët pjesëmarrës në provim.
 6. Nëse ndonjë prej anëtarëve të komisionit, për arsye madhore nuk mund të marrë pjesë në provim, Përgjegjësi i Njesisë Bazë me miratim të Dekanit cakton, me shkrim, një tjetër staf akademik. Në rast pamundësie zëvendësimi apo në rast të mungesës së kryetarit të komisionit, me vendim të Dekanit, provimi shtyhet jo më shumë se 5 (pesë) ditë pas datës së fundit të përfundimit të sezonit.
 7. Studenti është i detyruar të paraqitet në provim me dokument identifikimi.
 8. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet i vlerësuar negativisht.
 9. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit.
 10. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur.
 11. Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.
 12. Studenti ka të drejtë të ankohej, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanat. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve.
 13. Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studentin të japë përsëri provimin, me të njëjtin komision dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda



sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.

Neni 20

Dokumentimi i vlerësimit të studentëve

1. Fleta e Provimit është dokumenti i vetëm i cili dokumenton vlerësimin e studentit në provim. Prezenca ose jo e emrit të studentit në fletën e provimit përcakton edhe hyrjen ose jo të studentit në provim. Fleta e provimit hartohet mbi bazën e grupit. Në fletën e provimit shënohen vetëm studentët që kanë fituar të drejtën të hyjnë në provim.
2. Në Fletën e Provimit regjistrohen emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës. Ajo plotësohet dhe mbyllet nga sekretaria mësimore, nënshkruhet nga Dekani përkundrejt nënshkrimit të sekretarisë dhe mban vulën e Fakultetit. Fleta e Provimit i dorëzohet komisionit të provimit ditën e provimit. Me përfundimin e provimit, kryetari i komisionit e dorëzon atë në sekretari. Në asnjë rast Fleta e Provimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.
3. Nota e provimit shënohet me numër e me fjalë dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Për studentin që nuk paraqitet në provim shënohet në fletën e provimit cilësimi “nuk u paraqit”. Për studentët që kanë përmbushur 25% të mos frekuentimit shënohet në fletën e provimit cilësimi “nuk fiton”. Fleta e provimit, e plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit. Parregullsitë që lidhen me plotësimin apo me dorëzimin e këtij dokumentacioni ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e komisionit.
4. Në përfundim të provimit kryetari i komisionit të provimit në praninë e anëtarëve të komisionit, bazuar në manualin e hedhjes së notave në sistem nga pedagogët, aksesohet në sistemin PITAGORA, në llogarinë personale dhe cakton, në Proces Verbalin e Provimit digjital, vlerësimin e komisionit për secilin prej studentëve, në përputhje me Fletën e Provimit. Proces Verbali i Provimit shkarkohet nga kryetari i komisionit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.
5. Proces Verbali i Provimit, i plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit. Parregullsitë që lidhen me plotësimin apo me dorëzimin e këtij dokumentacioni ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e komisionit dhe anëtarët e tij.
6. Sekretaritë mësimore nuk duhet të pranojnë asnjë procesverbal të paplotësuar me të gjitha firmat e anëtarëve të komisionit.
7. Në rast të gabimeve në plotësimin e fletës së provimit, hartohet një procesverbal me firmat e anëtarëve të komisionit të provimit, përgjegjësit të njësisë bazë dhe Zv. Dekanit. Dekani merr vendimin për asgjësimin e fletës së provimit të hartuar gabim dhe lëshimin e një flete të re provimi.

Neni 21

Kushtet e kalimit në vitin pasardhës

1. Viti Akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës.
2. Si për të gjitha programet e studimit ashtu edhe për programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se



- 48 kredite të vitit të parë, sipas përcaktimit dhe në varësi të Rregullores së Fakultetit të Muzikës.
3. Studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 96 kredite.
 4. Studenti shpallet përsëritës i vitit kur:
 - a) Nuk plotëson kushtet e caktuara pikat 2-3 të këtij neni.
 - b) Përfshihet një vit nga shkolla për shkelje të rregullave të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, në Statutin e UART si dhe rregulloreve përkatëse.
 5. Studenti përsëritës ka këto të drejta e detyrime:
 - a) I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim.
 - b) Mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës me 25% të mungesave dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët, për të cilat ka detyrim frekuentimin.
 - c) Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit mësimor dhe programeve mësimore.
 - d) Të ripaguajë tarifën vjetore të shkollimit që i përket vitit akademik, në të cilin do të rifillojë studimet.

Neni 22

Përmirësimi i notave

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë të përmirësojë notën. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësojë studenti është e një detyrimi të vitit që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë deri në 3 (tre) nota gjatë tre viteve të ciklit të parë të studimit. Ai nuk ka të drejtë të përmirësojë notën e lëndës speciale.
2. Për përmirësimin e notës, studentët e vitit të parë dhe vitit të dytë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm 1 (një) herë dhe vetëm në sezonin e vjeshtës. Studentët e kursit të tretë kanë të drejtë të hyjnë në riprovim vetëm në sezonin e verës dy javë para mbrojtjes së diplomës.
3. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Përgjegjësit të Departamentit të Interpretimit jo më vonë se një javë pas përfundimit të provimit përkatës. Në bazë të vendimit që merr përgjegjësi i departamentit në zbatim të rregulloreve të UART, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.
4. Kur student i kërkon të përmirësojë vlerësimin e marrë në provim, si notë përfundimtare mbetet vlerësimi i bërë mbas kërkesës për përmirësim. Kur student i ka bërë kërkesë për përmirësim note, por nuk paraqitet në provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme.
5. Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë modulën.

KREU VI

TRANSFERIMET, NJOHJA E KREDITEVE DHE EKUIVALENTIMI I LËNDËVE

Neni 23

Transferimi i studimeve në të njëjtin program studimi,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ndryshimi i programit të studimit, Apelimi dhe Rregjistrimi i Vendimmarrjes, pezullimi i studimeve, ndërprerja e studimeve, largimi.

Për transferimet e studimeve, ndryshimin e programit të studimit, apelimi në rast se studenti nuk bie dakord me vendimmarrjen e komisionit të ekuivalentimit, rregjistrimin e vendimmarrjes përfundimtare, pezullimin e studimeve, ndërprerja e studimeve dhe largimi, për studentët që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz” do të veprohet sipas neneve përkatëse në Rregulloren e ciklit të parë të studimeve në UART.

KREU VII

PRAKTIKA PROFESIONALE ARTISTIKE

Neni 24

Organizimi i praktikës profesionale artistike

1. Kur praktika mësimore parashikohet si pjesë e planeve mësimore dhe përmban një numër kreditesh të caktuara, studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj.
2. Praktikrat profesionale artistike zhvillohen në ambientet e UART ose në institucione, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e personelit akademik të caktuar nga Departamenti i Interpretimit. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
3. Në rastet e kryerjes së praktikës profesionale artistike jashtë ambienteve të UART, Personeli Akademik që e drejton atë, mban lidhje me Institucionin ku ajo kryhet.
4. Në përfundim të praktikës profesionale artistike, studenti vlerësohet me notë ose me vlerësimin pozitiv/negativ.

KREU VIII

DIPLOMIMI

Neni 25

Modalitetet e diplomimit

1. Në përfundim të programit të studimit, studentët diplomohen në programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”. Provimi i Diplomës kryhet si më poshtë :
 - Mbrojtja artistike e diplomës me anë të koncertit bazuar në syllabusin përkatës.
2. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve siç parashikohet në planin dhe programin mësimor të studimit.
3. Studenti, para mbrojtjes së diplomës, duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me UART.



4. Fakulteti i Muzikës, brenda dy muajsh nga dita e fillimit të vitit shkollor, ju bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet dhe temat e diplomës sipas specifikës së programit në marrëveshje me studentin.

Neni 26

Mbrojtja e diplomës; Vlerësimi dhe Lëshimi i diplomës

Mbrojtja e diplomës realizohet me Koncert;

Kjo mbrojtje konsiston në:

- Titujt dhe referencat në stilet e muzikës jazz të pjesëve të koncertit; përgatitja e aranzhimeve për ansamblin e koncertit të diplomës (origjinale ose transkriptime);
- Dorëzimi i aranzhimeve të përfunduara në formë elektronike dhe të printuar 21 ditë përpara datës së diplomës;
- Përgatitja individuale dhe provat në ansambël;
- Organizimi i mbrojtjes së diplomës: Sigurimi i bazës teknike për realizimin e koncertit të diplomës (backline, sistem audio dhe ndriçim); Përgatitja për regjistrimin e koncertit të diplomës;

Të gjithë hapat e mësipërme ndiqen nga pedagogu udhëheqës i diplomës;

Për punimin e diplomës, përgatitjen e saj, organizimin e mbrojtjes së diplomës, vlerësimi i punimit si dhe lëshimi i diplomës, për studentët që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në “Muzikë Jazz” do të veprohet sipas neneve përkatëse në Rregulloren e ciklit të parë të studimeve në UART.

Neni 27

Suplementi i diplomës

1. Suplementi i diplomës përmban të paktën të dhënat e mëposhtme:

- a) Informacion për mbajtësin e diplomës:
 - i. Mbiemër
 - ii. Emër
 - iii. Datëlindja (*data/ muaji/ viti*)
 - iv. Numri i amzës / matrikulimit
- b) Informacion identifikues mbi studimin e kryer
 - i. Diplomë në Bachelor në “Muzikë Jazz”,
 - ii. Fusha e studimit
 - iii. Emri dhe statusi i institucionit - Universiteti i Arteve – Tiranë, institucion publik
 - iv. Gjuha në mësimdhënie / provim është Gjuha shqipe.
- c) Informacion mbi nivelin e studimeve
 - i. Diplomë e Ciklit të Parë
 - ii. Kohëzgjatja normale e programit në vite
 - iii. Kushtet e pranimit (*diplomat që shërbejnë si prag hyrje në këtë program dhe kërkesat e tjera specifike si; konkurs, provim etj.*)
- d) Informacion mbi përmbajtjen e studimit dhe rezultatet e arritura
 - i. Forma e studimit *me kohë të plotë*



- ii. Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit
 - iii. Detajet e programit të studimit:
 - Notat e provimeve, kreditet e marra për lëndën speciale instrument të zgjedhur nga studenti në fillim të ciklit Bachelor në “Muzikë Jazz” midis këtyre instrumenteve jazz: Piano Jazz; Bateri dhe Perkusion Jazz; Kontrabas Jazz; Bas Elektrik Jazz; Saksofon Jazz;
 - Listën e provimeve, notat, kreditet e marra për lëndët e tjera karakterizuese, lëndët bazë, lëndët ndërdisiplinore/integruese, lëndët me zgjedhje, lëndët plotësuese dhe një shenjë për provimet e njohura nga një program tjetër.
 - iv. Skema/Sistemi i vlerësimit dhe banda e notave kaluese
 - v. Tema/Programi i diplomës, data dhe nota e diplomimit/Lloji i diplomës
 - vi. Mesatarja e ponderuar.
 - e) Informacion mbi mundësitë që të jep kualifikimi i fituar
 - i. Mundësia dhe aksesit për studime dhe programe të mëtejshme që të jep diploma e fituar.
 - ii. Mundësia e punësimit dhe të kualifikimit profesional për mbajtësin e kësaj diplome. *(aftësitë dhe kompetencat e fituara nga programi i studimit, mundësitë për karrierë profesionale, etj.)*
 - iii. Mbajtësi i kësaj diplome mund të punësohet në/si (statusi profesional që fiton)
 - Instrumentist solist jazz dhe i muzikës moderne;
 - Formacione moderne muzikore në programet televizive në mediat publike dhe private
 - Ansamblet apo grupet muzikore të muzikës jazz dhe asaj moderne për sektorin muzikor privat;
 - Orkestra Frymore e FA;
 - Orkestrat frymore të bashkive;
 - Shkollat artistike shtetërore dhe private;
 - Produksione muzikore të tregut muzikor kombëtar dhe ndërkombëtar në rolet: instrumentist, kompozitor dhe aranzhues;
 - Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore;
 - Orkestra e TKOB me repertorin e muzikës moderne i krijuar në fillim të shekullit XX deri më sot;
 - Orkestra simfonike RTSH-së me repertorin e muzikës moderne i krijuar në fillim të shekullit XX deri më sot;
 - Punonjës të administratës publike sipas legjislacionit në fuqi
 - f) Informacion për sistemin kombëtar të arsimit të lartë i cili jepet në modelin kombëtar të suplementit të diplomës.
 - g) Firma e Dekanit dhe vula e Fakultetit.
2. Në çdo rast teksti i modelit të suplementit të diplomës, dizenjimi i saj si dhe elemente të tjera të pa parashikuara në pikën 1 të këtij neni, propozohen nga fakulteti dhe miratohen në Senatin Akademik sipas Modelit Kombëtar të Suplementit të Diplomës.
 3. Suplementi i Diplomës nuk e zëvendëson Diplomën që jepet në përfundim të programit të kryer.

KREU IX



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VLERËSIMI I CILËSISË

Neni 28

Rishikimi periodik i programit të studimit

1. Fakulteti në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UART, organizon në fund të çdo viti Akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i Fakultetit të Muzikës, aktivizon grupin e rishikimit, i cili është përgjegjës për këtë proces. Gjatë këtij rishikimi vëmendje i kushtohet:
 - a) rishikimit të shpërndarjes së krediteve për disiplinat apo grup disiplinat përkatëse;
 - b) rishikimit të programeve mësimore të lëndëve të veçanta;
 - c) rishikimit të elementëve të përbërës të disiplinave dhe ndarja e krediteve ndërmjet tyre (leksione, speciale, seminare, detyra, projekte, laboratorë, etj.);
 - d) rishikimi i rregullores së programit të studimit;
 - e) rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës;
 - f) rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës;
 - g) rishikimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik;
 - h) rishikimi i proceduarve të kontrollit të dijeve / provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit;
 - i) rishikim i feedback-ut të marrë nga studenti.
2. Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit Akademik. Dekani i Fakultetit së bashku me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UART, organizojnë procesin e tërheqjes së opinioneve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha disiplinat. Procedura se si organizohet ky proces përcaktohet nga Rektori.
4. Pedagogët në përfundim të vitit mësimor bëjnë një relacion për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për disiplinën përkatëse, duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje, si dhe në lidhje me procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e marra.
5. Sekretaria e Fakultetit dhe Zv. Dekani monitorojnë në vazhdimësi ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë, në zhvillimin e mësimin, të cilat bëhen objekt në procesin e rishikimit.
6. Kryetari i degës së Fakultetit paraqet relacion me shkrim në lidhje me sigurimin e bazës materiale dhe regjistrimet e çdo mangësie të vërejtur.

Neni 29

Regjistrimi, Ruajtja e të dhënave, Raportimi

1. Të gjitha të dhënat e grumbulluara ruhen në një dosje të veçantë të programit të studimit në arkivin e Fakultetit të Muzikës. Kjo dosje i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit.
2. Raporti i rishikimit përcakton ndryshimet që duhet të bëhen në programin e studimit dhe rregulloren e tij mësimore, në procesin e implementimit, në bazën materiale e didaktike, në stafin Akademik, në procedurat e kontrollit të dijeve e vlerësimin e studentëve, në procesin e marrjes së feedback-ut nga studentët. Të gjitha rekomandimet regjistrohen në



- planin e veprimeve. Në planin e veprimeve vendosen personat përgjegjës dhe afatet e kryerjes së çdo aktiviteti.
- Raporti i rishikimit të programit të studimit analizohet nga senati Akademik, i cili e miraton atë. Rektorati merr masat për zbatimin e planit të veprimeve sipas afateve të përcaktuara

KREU X

INFORMIMI

Neni 30 Informimi i studentëve

- Në Universitetin e Arteve ka një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar tek studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj..
- Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:
 - në format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve;
 - në format elektronik në faqen zyrtare të UART, në rrjetet sociale, etj., i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët;
 - të shpallura në mjedise të Fakulteteve përkatëse.
- Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati Fakulteteve, Departamentet dhe Dekani në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, etj., i bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e UART, njoftimeve në faqen zyrtare, etj.

KREU XI

TE DREJTAT DHE DETYRAT E STUDENTIT

Neni 31 Të drejtat e Studentit

Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në UART kanë këto të drejta:

- Të përfaqësohen në organet e UART, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
- Të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UART, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
- Të ndjekin lëndët e formimit artistik, leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me programin e studimit.
- Të përdorin infrastrukturën e UART dhe shërbime të tjera që ofrohen për ta.
- Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë.



- f) Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shpërblime të tjera të veçanta që administrohen nga UART.
- g) Të pajisen me diplomë, ose certifikatë, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme në përfundim të programit të studimit që ka ndjekur.
- h) Të marrin pjesë në mënyrë të programuar apo të organizuar në programe studimi jashtë njësisë kryesore ku studiojnë, të zhvillojnë një apo shumë semestra jashtë UART, si dhe t'u njihen kreditet dhe lëndët e zhvilluara.
- i) Të zhvillojnë praktika mësimore/profesionale, në institucione që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UART apo njësitë kryesore.
- j) Të pajisen me Kartën e Studentit dhe të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
- k) Të organizohen në organizata jofitimprurëse, brenda UART duke iu përmbytur përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 32

Detyrimet e studentit

Studenti është i detyruar:

- 1. Të zbatojnë Statutin, Rregulloren e UART, Rregulloren e Fakultetit të Muzikës, ku ndjekin studimet si dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Muzikë Jazz".
- 2. Të respektojnë Kodin e Etikës të UART.
- 3. Të sillen me korrektësi dhe të respektojnë të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe të studentëve të tjerë.
- 4. Të përmbushin në kohën dhe afatet e caktuara, si dhe me cilësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga programi i studimit dhe të marrin pjesë në gjithë veprimtaritë akademike që realizohen nga njësitë kryesore.
- 5. Të paguajnë tarifatat dhe detyrimet financiare për shërbimet e ofruara nga Fakulteti dhe UART.

Neni 33

Sjellja e studentëve

- 1. Studentët në ambientet e Universitetit të Arteve, duhet:
 - a. Të zbatojnë orarin e mësimi dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e UART.
 - b. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme si dhe përdorimin e një fjalori të përshtatshëm, me intonacione të rregullta sipas normave të Etikës, moralit dhe të mirësjelljes.
 - c. Të respektojnë personelin akademik, ndihmës mësimor artistik-shkencor dhe personelin administrativ, kolegët dhe rregullat e mësimi.
 - d. T'u drejtohen personelit akademik dhe atij administrativ në vetën e dytë shumësi si edhe me titujt akademikë përkatës.
 - e. Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj personelit akademik apo studentëve të tjerë, në mjediset e UART.
 - f. Të mos ofrojnë në asnjë formë, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve



- të larta, apo favorizime të tjera, për personelin akademik apo atë administrativ të UART, të cilët mund t' i kryejnë për shkak të detyrës.
- g. Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore.
 - h. Të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në ambientet e brendshme të UART.
 - i. Të mos përdorin celular ose ta mbajnë atë të fikur dhe në vend jo të dukshëm gjatë orarit të mëimit ose provimit.
 - j. Të përdorin tekstin mësimor gjatë orarit të provimit, vetëm nëse ky veprim është miratuar nga Fakulteti, (ose) njësia përkatëse ose pedagogu i lëndës.
 - k. Studenti i cili përfshihet në një veprim të perceptuar si shkelje e rregullave të Etikës, i cili rezulton në prishjen e orës së mëimit mund të drejtohet nga pedagogu të lerë auditorin për periudhën e mbetur të orës së mëimit. Studenti mund të përjashtohet nga auditori drejtpërdrejt nga vetë pedagogu i lëndës për një periudhë kohe. Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas “Tërheqjes së vëmendjes”, studentin mund të pezullohet nga pjesëmarrja në mësim për lëndën përkatëse, deri në marrjen e një vendimi nga Dekani.
 - l. Të mbajnë me vete përgjatë procesit mësimor kartën e studentit dhënë nga UART, dhe ta paraqesin/dorëzojnë atë sipas një kërkesë të bazuar nga anëtarët e stafit akademik apo administrativ të UART.
2. Si anëtarë të Universitetit të Arteve, studentët gëzojnë të drejtat dhe liritë si vijon:
- a. Çdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësia politike, mosha, gjinia dhe aftësive të kufizuara.
 - b. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikat e UART.
 - c. Studentët janë të lirë të organizojnë dhe të marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda UART. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në zbatim me rregulloren e UART. Organizatat e njohura dhe të pranuar mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e Universitetit sipas politikave dhe procedurave administrative të Universitetit të Arteve.
 - d. Studentët kanë të drejtën të jenë të lirë nga çdo lloj ngacmimi nga anëtarët e komunitetit të universitetit. Studentët kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të raportojnë, në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të Kodit të Etikës apo politike të universitetit tek drejtuesit akademikë apo administrativë të universitetit.
3. Studentët e akuzuar për shkeljen e Kodit të Etikës kanë të drejtat e mëposhtme:
- a. Të kenë në dispozicion të gjitha politikat dhe procedurat e universitetit lidhur me funksionimin e procesit disiplinor.
 - b. Të vihen në dijeni dhe të sqarohen siç kërkohet për akuzat e mbetura pezull.
 - c. Të jenë të lirë nga kërcënimet e personelit të universitetit në zgjidhjen e çështjes disiplinore.
 - d. Të përballen me akuzuesin (it) dhe të kenë mundësi të ri pyesin ata/ndonjë dëshmitar të pranishëm.
 - e. Të jenë të lirë nga kontrollat apo konfiskimet, përjashtuar rasteve kur këto bazohen në shkaqe të arsyeshme dhënë nga zyrtarët përkatës.

KREU XII



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DISPOZITA TË FUNDIT

**Neni 34
Ndryshimi i Rregullores**

- 1 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në përputhje me përcaktimet në Statutin e UART.
- 2 Çdo ndryshim i kësaj Rregullore miratohet nga Senati Akademik i UART.

**Neni 35
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UART.